



Senati i Universitetit të Prishtinës shpall:

## KONKURS

### për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2026-2027

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 20, pika 2, nënpika 2.2, dhe në zbatim të nenit 99 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2026, ka miratuar propozimet e njëjësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2026/2027 dhe ka miratuar kriteret për regjistrim në studimet e nivelit master.

#### I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti i Prishtinës, për studimet postdiplomike-master, për vitin akademik 2026-27, do të regjistrojë **2423** studentë, nga të cilët **9** studentë ndërkombëtarë.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij konkursi, duke u bazuar në UA (MASHT) Nr. 09/2016, universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri **282** studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në studimet postdiplomike-master në Universitetin e Prishtinës mund të pranohen kandidatët, të cilët kanë përfunduar studimet bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët, të cilët i kanë mbaruar studimet themelore-bachelor në Universitetin e Prishtinës.
4. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë, të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Në raste të tilla, diploma duhet të jetë e njohur dhe e barasvlerësuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Kosovës, përmes vendimit përkatës për njohje dhe barasvlerësim. Barasvlera e notave do të bëhet nga koordinatori për zhvillim akademik në fakultetin përkatës.
5. Përjashtim nga paragrafi 3 i pikës I të këtij konkursi bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcaktojnë vetë njësitë akademike.

6. Universiteti i Prishtinës, mbi bazën e konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e aplikimit, do t'ua shtojë nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.
7. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër, pa i përfunduar studimet ose pa u çregjistruar nga programi ku janë duke vijuar studimet.**
8. **Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2026/27 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.**

## II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:  
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
  - Suksesi në studimet themelore deri në 30 pikë;
  - Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.
2. Përveç provimeve nga lëndët profesionale, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit edhe në gjuhë angleze, nga i cili mund të sigurojnë deri në 10% të pikëve të provimit pranues. Nëse kandidati dëshmon që ka certifikatë ndërkombëtare TOEFL me së paku 79 pikë (ose IELTS me së paku 5.65 pikë), i njëjti me automatizëm merr 5 pikë, ndërsa pikët tjera lidhur me gjuhën angleze shtohen varësisht nga suksesi i treguar në provimin pranues - pjesën e gjuhës angleze.
3. Përjashtim nga paragrafi 2 i kësaj pike do të bëhet për kandidatët që aplikojnë në programet e gjuhëve të huaja në Fakultetin e Filologjisë, ku provimi do të mbahet në gjuhën e programit studimor.
4. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
5. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
6. Kandidatët, të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen, edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatëve të tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta, atëherë do të merret parasysh nota mesatare e studimeve paraprahe. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë femërore, përzgjedhja e kandidatëve për pranim do të bëhet përmes shortit nga komisioni i fakultetit në prezencën e kandidatëve me

pikë të barabarta. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga komisioni i fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta. Sekretari i fakultetit përkatës është i obliguar që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojë Zyrës për Shërbime të Studentëve të universitetit, gjithashtu ta dërgojë për publikim në ueb-faqen e fakultetit.

8. Në qoftë se në afatin e parë të konkursit mbesin vende të paplotësuara për shkak se jo të gjithë kandidatët kanë arritur të kalojnë prapun minimal të pikëve, atëherë do të shpallet konkurs plotësues për plotësimin e vendeve të lira.
9. Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimin ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal i studentëve, i përcaktuar me rregullore apo akt tjetër të brendshëm.

### **III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM**

**Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:**

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> hapet prej datës **29.06.2026** deri me datë **10.07.2026**, në orën **14:00**. Gjatë kësaj periudhe, do të bëhet edhe dorëzimi i dokumentacionit fizik nga kandidatët. Dokumentacioni do të pranohet çdo ditë, me përjashtim të të dielave.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **29.06.2026**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **14:00**.
3. Gjatë periudhës së aplikimit do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula e noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim online dhe fizik është si në vijim:**
  - a) *Ekstraktin e lindjes (origjinale);*
  - b) *Diplomën, përkatësisht certifikatën e diplomimit, të noterizuar (dokument origjinal);*
  - c) *Dëshminë e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatë që kanë të mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private të Republikës së Kosovës);*
  - d) *Të ngarkohet një fotografi profesionale, e realizuar në fotostudio, sipas standardeve për dokumente zyrtare (si fotografia për pasaportë ose vizë). Fotografia duhet të jetë me dimensione 35 × 45 mm, me fytyrën ballë përballë, sfond të bardhë ose të pastër dhe të ruhet në formatin JPG, JPEG ose PNG.*
  - e) *Fletëparaqitja e plotësuar, e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegëza (Linku) për aplikim online përmes internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>***

f) Kandidatët, me rastin e aplikimit, bazuar në UA (MASHTI) Nr. 09/2021, lirohen nga pagesa e provimit pranues.

**Provimi pranues do të mbahet më 13.07.2026 dhe 14.07.2026, sipas orarit si në vijim:**

#### **Grupi I:**

1. Fakulteti Filozofik, datë **13.07.2026** në ora **9:00**
2. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, datë **13.07.2026** në ora **9:00**
3. Fakulteti i Ekonomisë, datë **13.07.2026** në ora **10:00**
4. Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinës, datë **13.07.2026** në ora **10:00**
5. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, datë **13.07.2026** fillon në ora **9:00-12:00**
6. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, më **13.07.2026** në ora **8:00**

#### **Grupi II.**

1. Fakulteti i Filologjisë, datë **14.07.2026** në ora **9:00**
2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, datë **14.07.2026** fillon në ora **9:00-11:00**
3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, datë **14.07.2026** fillon në ora **9:00-11:00**
4. Fakulteti Juridik, datë **14.07.2026** në ora **9:00**
5. Fakulteti i Mjekësisë, datë **14.07.2026** nga ora **15:00**
6. Fakulteti i Arteve, datë **14.07.2026** nga ora **9:00**.
7. Fakulteti i Arkitekturës, datë **14.07.2026** në ora **09:00**
8. Fakulteti i Edukimit, datë **14.07.2026** në ora **9:00**.

1. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të posedojnë letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.

2. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohej përdorimi i telefonave celularë!**

### **IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE**

1. **Shpallja e rezultateve preliminare** e provimit pranues për të dy grupet do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve, **më së voni deri më 15.07.2026, në ora 16:00.**
2. *Rezultati preliminar nuk është rezultat përfundimtar. Me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, pasi me rastin e miratimit si të bazuar të ankesës, dikush nga kandidatët mund të radhitet më lart me pikë se kandidati i radhitur sipas rezultatit preliminar.*

### **V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË**

1. Kandidatët, të cilët sipas rezultatit preliminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare, respektivisht: për të dy grupet më së voni deri më 17.07.2026, në ora 16:00.**

2. Pas afatit të përcaktuar si në pikën e sipërshtënuar, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet menjëherë pas mbylljes së afatit ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga fakulteti përkatës.

## VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. **Shpallja e rezultateve përfundimtare** të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse, pas shqyrtimit të ankesave dhe atë:
  - 1.1. Për dy grupet më së voni deri me datë **18.07.2026, në ora 16:00.**
2. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **20.07.2026-22.07.2026.**

## VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

Regjistrimi i studentëve të pranuar realizohet në mënyrë automatike nga Administrata Qendrore, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga njësia akademike.

### **I. FAKULTETI FILOZOFIK**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **240** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti Filozofik</b>	<b>212</b>	<b>28</b>	<b>240</b>
<b>Departamenti i Filozofisë</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>40</b>
Programi Filozofi Politike	35	5	40
<b>Departamenti i Historisë</b>	<b>53</b>	<b>7</b>	<b>60</b>
Programi Histori Koha e Re	35	5	40
Programi Arkivistikë	18	2	20
<b>Departamenti i Shkencës Politike</b>	<b>26</b>	<b>4</b>	<b>30</b>
Programi Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	26	4	30
<b>Departamenti i Sociologjisë</b>	<b>26</b>	<b>4</b>	<b>30</b>
Programi Sociologji	26	4	30
<b>Departamenti i Psikologjisë</b>	<b>36</b>	<b>4</b>	<b>40</b>

Programi Psikologji shkollorë dhe Këshillim	18	2	20
Programi Psikologji Klinike dhe Komuniteti	18	2	20
<b>Departamenti i Antropologjisë</b>	<b>36</b>	<b>4</b>	<b>40</b>
Programi Trashëgimi kulturore	36	4	40

### ***Programi Filozofi Politike***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e filozofisë apo shkencat politike, sociologjia, historia, antropologjia, puna sociale, gazetaria, psikologjia, ekonomia, edukimi, administrata publike, drejtësia dhe letërsia.
- T'i nënshtrohen testimit lidhur me njohuritë profesionale nga filozofia, shkenca politike dhe sociologjia.

### ***Programi Histori Koha e Re***

- Mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (së paku 180 ECTS) në drejtimet: Histori, Sociologji, Antropologji, Shkencë politike, Filozofi, Psikologji, Punë sociale, Edukim, Gazetari, Juridik.
- Testi pranues do të organizohet në mënyrë dominante nga fusha e historisë.

### ***Programi Arkivistikë***

- Mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (së paku 180 ECTS) në Shkencat sociale, Shkencat filologjike, Shkencat e Jurisprudencës dhe të Ekonomisë.
- Testi pranues do të organizohet në mënyrë dominante nga fusha e historisë.

### ***Programi Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci***

- T'i kenë të përfunduara me sukses studimet themelore në fushën e Shkencave Politike, Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë, Administratës Publike, Drejtësisë, Ekonomisë, Historisë, Sociologjisë, Filozofisë, Punës Sociale, Gazetarisë, Letërsisë, Ballkanistikës.
- Testi pranues do të organizohet nga fusha e shkencave politike, historisë, ekonomisë dhe drejtësisë.

### ***Programi Sociologji***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e Sociologjisë, Punës Sociale, Antropologjisë, Shkencës Politike, Filozofisë, Psikologjisë, Historisë, Edukimit, Gazetarisë.
- Testi pranues do të organizohet nga fusha e sociologjisë.

### ***Programi Psikologji Shkollorë dhe Këshillimi***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e psikologjisë;
- Testi pranues do të organizohet nga fusha e psikologjisë dhe do të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze.

### ***Programi Psikologji Klinike dhe Komuniteti***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e psikologjisë;
- Testi pranues do të organizohet nga fusha e psikologjisë dhe do të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze.

### ***Programi Trashëgimi kulturore***

- T'i kenë përfunduar studimet bachelor (së paku 180 ECTS) nga fusha e antropologjisë, etnologjisë, arkeologjisë, trashëgimisë kulturore, historisë, sociologjisë, arkitekturës, letërsisë, gazetarisë, gjuhësisë, arteve dhe gjeografisë.
- Testi do të organizohet nga fusha e antropologjisë, arkeologjisë, historisë, sociologjisë.

## **II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKO-NATYRORE**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **210** studentë dhe atë:

<b>Departamenti-Programi</b>	<b>Për studime të rregullta</b>	<b>Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore</b>	<b>184</b>	<b>26</b>	<b>210</b>
<b>Departamenti i Matematikës</b>	<b>61</b>	<b>9</b>	<b>70</b>
Programi Matematikë me zbatime	35	5	40
Programi Shkencë Kompjuterike	26	4	30
<b>Departamenti i Fizikës</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Fizikë	18	2	20
<b>Departamenti i Kimisë</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>40</b>
Programi Kimi Organike	13	2	15
Programi Kimi Analitike me Mjedis	13	2	15
Programi Shkenca e Materialeve	9	1	10
<b>Departamenti i Biologjisë</b>	<b>52</b>	<b>8</b>	<b>60</b>
Biologji	26	4	30
Programi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	26	4	30
<b>Departamenti i Gjeografisë</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Gjeografi	18	2	20

Provimi pranues dhe kushtet e aplikimit sipas programeve:

- **Msc.Kimi Organike,**
- **Msc.Kimi Analitike&Mjedis,**
- **Msc.Shkenca e materialeve**

*Kane te drejte aplikimi kandidatet te cilët kane përfunduar studimet bachelor si ne vijim:*

- 1.Bsc.Kimi;
- 2.Bsc.Kimi Inxhinierike;

- 3.Bsc.Kimi Ushqimore;
- 4.Bsc.Farmaci;
- 5.Bsc.Bioteknologji Ushqimore.

Kandidatet te cilët aplikojnë nuk do ti nënshtrohen provimeve diferenciale.

Programi Kimi Organike, Shkenca e materialeve, Kimi Analitike dhe e Mjedisit, provimi do të jetë nga Kimia;

Të gjithë studentët që kanë përfunduar studimet BSc kanë të drejtë të aplikojnë në programet:

- **Master në Matematikë me Zbatime dhe**
- **Shkencë Kompjuterike**

Pa iu nënshtuar provimeve shtesë, por duke iu nënshtuar provimit pranues.

Programi Matematikë me Zbatime, provimi do të jetë nga Matematika;

Programi Shkenca Kompjuterike, provimi do të jetë nga Shkenca Kompjuterike.

**Për programin e MSc. Gjeografi**, mund te aplikojnë nga fusha e studimeve të gjeografisë, kudo që kanë përfunduar studimet.

Provimi do të jetë nga Gjeografia;

Në programet:

- **MSc. Biologji dhe**
- **MSc. Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit**

Mund të aplikojnë studentë nga IAL publike dhe private të cilët kanë përfunduar studimet themelore (BSc) nga fusha e biologjisë (Biologji, Ekologji, Mjedis, Biologji molekulare), fusha e mjekësisë, fusha e bujqësisë, fusha e edukimit dhe fusha tjera që kanë interes për studime. Studentët e pranuar nuk do të u nënshtrohen provimeve diferenciale.

Programi Biologji, provimi do të jetë nga Biologjia;

Programi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, provimi do të jetë nga Biologjia;

**Për programin MSc. Fizikë**, mund te aplikojnë nga fusha te afërta te studimeve, kudo qe kanë përfunduar studimet.

Programi Fizikë, provimi do të jetë nga Fizika;

### **III. FAKULTETI I FILOLOGJISË**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **190** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Filologjisë</b>	<b>168</b>	<b>22</b>	<b>190</b>
Programi Gjuhë Shqipe	26	4	<b>30</b>
Programi Letërsi Shqipe	22	3	<b>25</b>
Programi Gjuhë Angleze- Program i integruar i gjuhësisë	18	2	<b>20</b>
Programi Letërsi Angleze	18	2	<b>20</b>
Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	18	2	<b>20</b>

Programi Gjermanishtja si gjuhë e huaj	13	2	15
Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge	18	2	20
Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke	13	2	15
Programi Gazetari dhe marrëdhënie me publikun	22	3	25

### **Provimi pranues dhe kushtet e aplikimit sipas programeve:**

#### **Master Programi në Gjuhë Shqipe (MA, 60 ECTS)**

Në këtë program mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (minimumi 240 ECTS) në drejtimin Gjuhë Shqipe dhe nga të gjitha fushat e shkencave shoqërore në universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Testi pranues do të organizohet nga lëndët e gjuhësisë, respektivisht të lëndëve: 1. Norma e shqipes së shkruar; 2. Fonetikë; 3. Morfologji; 4. Leksikologji; 5. Sintaksë; 6. Histori e gjuhës shqipe; 7. Sociolinguistikë dhe 8. Psikolinguistikë.

#### **Master Programi Letërsi shqipe (MA, 60 ECTS)**

Mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (së paku 240 ECTS) në drejtimet Letërsi shqipe dhe Gjuhë dhe letërsi shqipe në universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Testi pranues do të organizohet nga lëndët e fushës së letërsisë si në vijim: 1. Teori e letërsisë; 2. Letërsi e romantizmit shqiptar; 3. Letërsi moderne shqipe; 4. Letërsi botërore dhe 5. Letërsi e sotme shqipe.

#### **Master Departamenti Gjuhë dhe letërsi angleze:**

##### **Programi Letërsi (MA, 60 ECTS)**

##### **Programi i Integruar i Gjuhësisë (MA, 60 ECTS)**

Mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (së paku 240 ECTS) në drejtimet: Gjuhë dhe letërsi angleze në universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Testi pranues për Programin Letërsi do të organizohet nga fusha e letërsisë angleze si në vijim: 1. Analizë e veprës letrare dhe 2. Letërsi moderne angleze dhe amerikane.

Testi pranues për Programin e Integruar të Gjuhësisë do të organizohet nga lëndët e fushës së gjuhësisë angleze dhe mësimdhënies si në vijim: 1. Anglishtja për qëllime akademike; 2. Analizë morfo-sintaksore dhe 3. Metodologjia e mësimdhënies.

#### **Master Departamenti Gjuhë dhe letërsi gjermane**

##### **Programi Gjuhë dhe letërsi gjermane (MA, 60 ECTS)**

##### **Programi Gjermanishtja si gjuhë e huaj (MA, 60 ECTS)**

Mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (së paku 240 ECTS) në drejtimin: Gjuhë dhe letërsi gjermane në universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Testi pranues do të organizohet për programin Gjuhë dhe letërsi gjermane nga fusha e gjuhësisë dhe letërsisë gjermane.

Testi pranues për Gjermanishtja si gjuhë e huaj do të organizohet nga fusha e gjuhësisë dhe metodikës së gjermanishtes.

#### **Master Programi Gjuhë dhe letërsi frënge (MA, 60 ECTS)**

Mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (së paku 240 ECTS) në drejtimin Gjuhë dhe letërsi frënge.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e lëndëve: 1. Gjuhësi frënge; 2. Letërsi frënge dhe 3. Metodikë/didaktikë.

#### **Master Programi Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun (MA, 120 ECTS)**

Mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (së paku 180 ECTS) në drejtimet: Gazetari, Shkenca Politike, Juridik, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Sociologji dhe Gjuhë shqipe në universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e gazetarisë, respektivisht të lëndëve: 1. Hyrje në gazetari; 2. Zhanret e gazetarisë; 3. Marrëdhënie me publikun dhe 4. Komunikim Masiv.

#### **Master Programi Gjuhë dhe letërsi turke (MA, 60 ECTS)**

Mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor (së paku 240 ECTS) në drejtimin Gjuhë dhe letërsi turke dhe Edukimi në gjuhën turke në universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e lëndëve: 1. Gjuhë e sotme turke; 2. Letërsi e sotme turke dhe 3. Zhvillimi historik i turkologjisë.

### **IV. FAKULTETI JURIDIK**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **245** studentë dhe atë:

<b>Departamenti-Programi</b>	<b>Për studime të rregullta</b>	<b>Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Fakulteti Juridik</b>	<b>216</b>	<b>29</b>	<b>245</b>
E Drejta Kushtetuese dhe Administrative	31	4	<b>35</b>

E Drejta Civile dhe Pronësore	31	4	35	
E Drejta Penale	31	4	35	
E Drejta Ndërkombëtare	26	4	30	
E Drejta Financiare	26	4	30	
Kontrata dhe e Drejta Komerciale	31	4	35	
Studimet e Avancuara Evropiane (programi në Gjuhën Angleze)	22	3	20	
Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale (programi në Gjuhë Angleze)	Studentë të rregullt jo ndërkombëtarë	15	3	25
	Studentë nga të punësuarit në institucionet publike që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut <sup>1</sup>	2		
	Studentë ndërkombëtarë	5		

**Provimi pranues do të mbahet nga lëndët:**

**Programi: E Drejta Kushtetuese Administrative:**

1. E drejta kushtetuese;
2. E drejta administrative;
3. Fillet e së drejtës.

**Programi: E Drejta Civile dhe e Pronës:**

1. E drejta civile (e drejta civile, pjesa e përgjithshme dhe e drejta sendore);
2. E drejta e detyrimeve;
3. E drejta e procedurës civile (procedura kontestimore).

**Programi: E Drejta Penale:**

1. E drejta penale;
2. E drejta e procedurës penale;
3. Kriminologji dhe Penologji.

**Programi: E Drejta Ndërkombëtare:**

1. E Drejta e Bashkimit Evropian;
2. E Drejta Ndërkombëtare Publike;
3. E Drejta Ndërkombëtare Private.

**Programi: E Drejta Financiare:**

1. Financat dhe e drejta financiare;
2. Ekonomia;
3. E drejta tatimore dhe buxhetore.

<sup>1</sup> Në vendet e lira për kandidatët që punojnë në institucione publike (institucionet e nivelit qendror, lokal dhe institucionet e pavarura) duhet të paraqesin edhe një dëshmi që konfirmon se janë të punësuar në këto institucione dhe së detyrat e punës së tyre janë nga fusha e të drejtave të njeriut, hulumtimi dhe dokumentimi i krimeve të kryera gjatë luftës apo drejtësia tranzicionale.

**Programi: Kontrata dhe e Drejta Komerciale:**

1. E drejta e detyrimeve;
2. E drejta tregtare (biznesore);
3. Arbitrazhi.

**Programi: Studimet e Avancuara Evropiane (Program në Gjuhë Angleze)**

1. European Union Law;
2. Public International Law;
3. Theory of International Law.

**Programi: Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale (Program në Gjuhë Angleze):**

1. Theory and Practice of Human Rights;
2. Introduction to International Criminal Law (*incl. The history of International Criminal Tribunals*);
3. Introduction to Transitional Justice.

Në studimet postdiplomike-master në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet bachelor 4 (katërvjeçar), respektivisht 240 ECTS.

**Të drejtë konkurrimi kanë vetëm studentët që kanë përfunduar studimet bachelor në drejtimin përkatës (Fakulteti Juridik), me përjashtim të programeve në gjuhë angleze.**

**Për programet në gjuhë angleze:**

- Në Programin Studimet e Avancuara Evropiane (*European Advanced Studies*), të drejtë konkurrimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor në drejtimet: *juridik, ekonomik, shkenca politike, administratë publike, filozofi dhe shkenca sociale.*

**Provimi pranues mbahet në gjuhë angleze.**

- Në Programin Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale (*Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice*), të drejtë konkurrimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor në drejtimet: *juridik, shkenca politike, administratë publike, ekonomik, psikologji dhe shkenca sociale.*

**Programi në Gjuhë Angleze “Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale” të Fakultetit Juridik:**

Në kuadër të numrit të përgjithshëm të programit do të pranohen deri në **5** studentë ndërkombëtarë.

Për studentët ndërkombëtarë shpallet thirrje e veçantë në gjuhë angleze dhe për aplikim kërkohet të bashkëlidhen:

- Një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);
- Diplomën/at e studimeve paraprake;
- Letër motivuese referuar në programin që aplikon;
- Dëshmi tjera që mund të jenë relevante për programin nëse kandidati/ja i posedon (dëshmi për njohje të Gjuhës Angleze; certifikata apo dëshmi për kualifikime, etj.).

Për studentët ndërkombëtarë, pas përfundimit të aplikimeve, fakulteti organizon një intervistë me kandidatët dhe sesion informues për programin dhe kushtet e qëndrimit në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.

**Vërejtje:** Në rast se mbesin vende të lira nga kuota për studentët ndërkombëtarë, atëherë ato vende mund të plotësohen nga kandidatët e rregullt që janë në listën e pritjes dhe e kanë arritur pragun e kalueshmërisë, nëse për këtë merr vendim komisioni për pranim.

## **V. FAKULTETI I EKONOMISË**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **432** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Ekonomisë</b>	<b>386</b>	<b>46</b>	<b>432</b>
Programi Banka dhe Financa	88	12	<b>100</b>
Programi Menaxhment	106	14	<b>120</b>
Programi Marketing	46	6	<b>52</b>
Programi Ekonomiks (Gjuhë Shqipe)	73	7	<b>80</b>
Programi Kontabilitet	73	7	<b>80</b>

Të drejtën e aplikimit në nivelin Master në Fakultetin e Ekonomisë e kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor me 180 ECTS në fushën e ekonomisë dhe biznesit, përfshirë programet: Banka dhe Financa, Menaxhment, Marketing, Kontabilitet, Ekonomiks, Administrim Biznesi, Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime, Biznes dhe Ekonomi, si dhe programe të tjera të ngjashme nga fusha e ekonomisë dhe biznesit.

### **Provimi pranues do të mbahet si në vijim:**

Provimi në të gjitha programet do të mbahet me shkrim.

#### **Programi Banka dhe Financa, në lëndët:**

- a. Financa
- b. Financa të korporatave.

#### **Programi Menaxhment, në lëndët:**

- a. Menaxhment
- b. Menaxhment i NVM-ve.

#### **Programi Ekonomiks, në lëndët:**

- a. Mikroekonomi
- b. Makroekonomi.

#### **Programi Marketing në lëndët:**

- a. Marketing
- b. Sjellje konsumatori.

#### **Programi Kontabilitet në lëndët:**

- a. Raportim financiar
- b. Kontabiliteti menaxherial.

## **VI. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **80** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet joshumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit</b>	<b>72</b>	<b>8</b>	<b>80</b>
<b>Departamenti i Konstruksioneve</b>	<b>36</b>	<b>4</b>	<b>40</b>
Programi Konstruktiv	36	4	40
<b>Departamenti Gjeodezi</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Gjeodezi	18	2	20
<b>Departamenti Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore	Studentë të rregullt jo ndërkombëtarë	14	20
	Studentë ndërkombëtarë	4	

**Për Programin Konstruktiv, MIRU dhe Gjeodezi**, të drejtë aplikimi kanë studentët të cilët kanë përfunduar studimet bachelor të drejtimeve përkatëse dhe kanë grumbulluar 180 ECTS.

Provimi pranues do të mbahet nga fushat e studimit përkatës ku aplikojnë kandidatët.

**Në Programin Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU/IWRM), në kuadër të numrit të përgjithshëm, do të pranohen deri në 4 studentë ndërkombëtarë.**

Provimi pranues në Programin Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU/IWRM) mbahet në gjuhën angleze dhe atë për fushat:

- a. Hidroteknikë (Hydrotechnics),
- b. Inxhinieri e ambientit (Environmental Engineering) dhe/and
- c. Shkenca të natyrës (Natural sciences).

Për studentët ndërkombëtarë provimi organizohet në versionin virtual.

Për studentët ndërkombëtarë do të shpallet edhe thirrje e veçantë në gjuhë angleze dhe sipas këtij konkursi për aplikim, kërkohet të bashkëlidhen:

- Një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);
- Diplomën/at e studimeve paraprake;
- Letër motivuese;
- Dëshmi tjera që mund të jenë relevante për programin nëse kandidati/ja i posedon (dëshmi për njohje të gjuhës angleze; certifikata apo dëshmi për kualifikime, etj.).

Për studentët ndërkombëtarë, pas përfundimit të aplikimeve, fakulteti organizon një intervistë me kandidatët dhe sesion informues për programin dhe kushtet e qëndrimit në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.

Vërejtje: Në rast se mbesin vende të lira nga kuota për studentët ndërkombëtarë, atëherë ato vende plotësohen nga kandidatët e rregullt që janë në listën e pritjes dhe e kanë arritur pragun e kalueshmërisë.

## **VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **130** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>FIEK</b>	<b>114</b>	<b>16</b>	<b>130</b>
Programi Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	44	6	<b>50</b>
Programi Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	26	4	<b>30</b>
Programi Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	18	2	<b>20</b>
Programi Elektroenergjetikë dhe Menaxhimi i Energjisë	26	4	<b>30</b>

Provimi pranues dhe kushtet e aplikimit sipas programeve:

### **1. Programi Master: Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike (IKS)**

Fushat kryesore që do të përfshihen në provimin pranues për pranim në programin Master **Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike** janë: Programimi, Algoritmet dhe Strukturat e të Dhënave, Programimi i Orientuar në Objekte, Arkitektura e Kompjuterëve, Sistemet Operative, Sistemet e Shpërndara, Bazat e të Dhënave, Web Programimi dhe Siguria e të Dhënave, si dhe Gjuha angleze.

Në këtë program mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor (180 ECTS) në programet: Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, Inxhinieri kompjuterike, Shkenca Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Informatikë e Aplikuar, si dhe Shkenca Kompjuterike – Dizajnimi i Softuerëve.

### **2. Programi Master: Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë (EAR)**

Fushat kryesore që do të përfshihen në provimin pranues për pranim në programin Master **Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë** janë: Bazat e Inxhinierisë Elektrike, Sinjalet dhe Sistemet, Automatika, Bazat e Elektronikës, Elektronika Analoge, Elektronika Digjitale si dhe Gjuha angleze. Në këtë program mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor (180 ECTS) në programet: Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë, Elektronikë, Automatikë e kompjuterizuar dhe Robotikë, Elektroenergjetikë si dhe Mekatronikë.

### **3. Programi Master: Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)**

Fushat kryesore që do të përfshihen në provimin pranues për pranim në programin Master **Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimet** janë: Telekomunikacionet, Rrjetat Kompjuterike, Komunikimet Digjitale, Përpunimi i Sinjaleve, Komunikime pa tela (mobile), Teknologjitë e Internetit dhe Gjuha angleze.

Në këtë program mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor (180 ECTS) në programet: Telekomunikacion, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit,

### **4. Programi Master: Elektroenergjetikë dhe Menaxhimi i Energjisë**

Fushat kryesore që do të përfshihen në provimin pranues për pranim në programin Master **Elektroenergjetikë Menaxhimi i Energjisë** janë: Makinat Elektrike dhe Transformatorët, Bartja dhe

Shpërndarja e Energjisë Elektrike, Centralet Elektrike, Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, Instalimet Elektrike, Mbrojtja me Rele, Menaxhimi i Projekteve dhe Ndërmarrësia si dhe Gjuha angleze.

Në këtë program mund të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor (180 ECTS) në programet: Elektroenergjetikë, Sistemet Elektroenergjetike dhe Elektroenergjetikë Industriale.

### **VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **90** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike</b>	<b>80</b>	<b>10</b>	<b>90</b>
<b>Programi Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme:</b>	<b>26</b>	<b>4</b>	<b>30</b>
Profili: Termoenergjetika dhe Termoteknika	13	2	15
Profili: Sistemet e Energjisë së Ripërtëritshme	13	2	15
Programi Komunikacion rrugor	18	2	20
Programi Mekatronikë	18	2	<b>20</b>
Programi Dizajn Inxhinierik dhe Automjete	18	2	<b>20</b>

Të drejtë aplikimi kanë studentët që kanë përfunduar studimet bachelor në fushën përkatëse dhe kanë grumbulluar 180 apo 240 ECTS.

Provimi pranues mbahet nga fusha e studimit përkatës ku aplikojnë kandidatët.

### **IX. FAKULTETI I MJEKËSISË**

